

VJERSHA  
DHE POEMA

BIBLIOTEKA  
SHËTETIT

84-1

1367

KIÇO  
BLUSHI


SONTE  
DHE  
NESËR  
NË  
MËNGJES

814-1  
13 67

KIÇO BLUSHI

# SONTE DHE NESËR NË MËNGJES

vjersha dhe poema



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SONTE DHE NESËR NË MËNGJES

Sonte, e qeshura jote  
nëpër qiellin e lagjes  
ndahet në qindra copëza-thërrime.  
Nesër në mëngjes, zogjtë,  
para se të marrin fluturimin e largët,  
do të fillojnë të ushqejnë këngën  
me të qeshurin tënd të mbrëmshëm,  
të ngelur e të shpërndarë  
mbi të gjitha çatitë  
e lagjes...

## EKSKAVATORI 4 M<sup>3</sup> DHE POETI

Si mijëra mendime  
bien mijëra pika shiu.  
Ekskavatori, mes baltës,  
kovën e zhyt në tokën e lagur.

Sa mirë do të ishte  
sikur çdo varg,  
para se ta hidhja në shtyp,  
thellë ta zhysja në tokën e dashur  
për të nxjerrë prej andej  
llucën që na ngjitet në çizme e në zemër,  
që na pengon të shkojmë më shpejt te  
e nesërmja,  
që na pengon të shkojmë më shpejt  
te pjesa më e mirë  
e vetes sonë.

## NATËN E MIRË, POLIC!

Kafenetë mbyllen.

Shoferët e fundit të urbanëve

nisen më këmbë për në shtëpi.

Batanijen e ftohtë të mesnatës shtërngojnë pas  
shpatullave bulevardet.

Natën e mirë, polic!

Njerëzit këthehen në dhomat e ngrohta.

Era e bukës së thekur,

parfumi i çarçafëve të pastër,

e puthura e fëmijës në gjumë,

çelësi i abazhurit që mezi pret të shtypet,

kockat e lodhura që mezi presin të çlodhen —

ndihen deri jashtë

në asfaltin e lagur.

Natën e mirë, polic!

Jemi të rrethuar.  
Kemi kaq shumë armiq.  
Një sy duhet mbajtur zgjuar  
që armiku i klasës, tinëz,  
të mos na verbojë.  
Natën e mirë, polic!

Nën mushamanë tënde  
nata s'duhet të sjellë ëndrra  
për krevate të ngrohtë,  
për gjumë pa shqetësime.  
Natën e mirë, polic!

Do të doja të të zëvendësoja sonte,  
të shkoje sonte edhe ti te gruaja,  
të shtriheshe sonte edhe ti i shkujdesur  
pranë gruas,  
pranë kalamajve,  
pranë qetësisë,  
Natën e mirë, polic!

Në kohëra të tilla  
u dashkërka të mbajmë njërin sy hapur.  
Ky sy sonte je ti,  
nesër jam unë,  
pasnesër im bir.  
Natën e mirë, polic!

Sonte harron ti  
qetësinë dhe ngrohtësinë e çarçafëve  
që të flejnë njëmijë të tjerë  
krejt të qetë,  
që bllokada, tinëz,  
sytë e lirisë të mos i nxjerrë.  
Natën e mirë, polic!

## ARMIKU I KLASËS

Gishtat mbushur me unaza,  
një palë këpucë të arnuara në sup,  
një thes me plehra nga koh' e Zogut,  
një zë që rrënjët i ka në nostalgjinë për sulltan  
Hamitin,  
një sahat që kohën e mat allaturka,  
një palë sy të mefshtë që shohin vetëm prapa,  
një palë duar të vockëla e të bardha që djersën  
e tjetrit lakmojnë —  
me vete solli  
në qytetin e studentëve  
i fundmi i matrapazëve,  
i fundmi i batakçinjve.

Erdhi,  
si igrasia e banjos  
kur çahet tubi i sifonit.



Erdhi

me shpresa të mëdha  
nga bursa e studentëve  
mos zhvaste diçka...

Ish-nëpunës i lartë i Zogut,  
sot i përkulur, dashmirës, ikurak;  
ish- «shtyllë e palujtshme e kombit»,  
sot i pavlerë, qesharak;  
ish-student në Francë a në Austri,  
sot matrapaz profesionist,  
profesionist batakçi.

Të gërmosh pak në shtëpi të tij  
veç ëndrrës së perënduar të qypave me florinj,  
veç tapive të djegura të tokave,  
veç qejfeve, kabareve, prostitutave  
do të gjesh diku  
të fshehur me kujdes  
diplomën për doktor: exellancë!  
mbiemrin e fikur:

oxhak i lartë,  
familje e lashtë

dhe fundin e tij e të fisit të tij,  
dhe hirin hakmarrës të kohës,  
që origjinën e tij  
përfundimisht e mbulon.

## **FIERZA**

Rrugë drejt maleve,  
male drejt rrugëve.

Fytyra të njohura  
që i kam parë  
në kinokronikat e vjetra tashmë,  
në kantieret që nuk ekzistojnë më.

Sa më shumë plaken dhe thinjen këta njerëz  
aq më të mëdhenj  
e më të fuqishëm  
i bëjnë hidrocentralet.